



Prishtinë, 07 gusht 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2315_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2571_07_24** i datës 03.07.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 09.07.2024.

në seancën e mbajtur më datë 07 gusht 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZHET si e pabazuar** ankesa e konsumatorit **A.H** nga Komuna e Fushë Kosovës, e parashtruar ndaj vendimit të DMK-së;
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2571_07_24 i datës 03.07.2024.
- III.** Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 03.07.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2571_07_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së cilës i kishte kontestuar faturat e energjisë elektrike, me njehsorin elektrik nr. 40128912 për shkak të dyshimit në lexim dhe faturim jo të saktë.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori **A.H** brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe
- Zbatim i gabuar i së drejtës materiale dhe procedurale.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.08.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 09.07.2024; Vendimin e DMK ZRRE/DMK_V_2571_07_24 të datës 03.07.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 15.01.2024; Përgjigjën e KESCO-s të datës 22.04.2024, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 25.04.2024; Procesverbalin e inspektimit nr. 2151109 të dt. 06.01.2024; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0213665 të dt. 06.01.2024; Rrjedhën e energjisë elektrike, Transaksionet dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bordi pasi që ka analizuar me kujdes shkresat e lëndës ka gjetur se, me datë 06.01.2024, punëtorët e autorizuar të KEDS, e kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe e kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve me TL = 41975 kWh dhe TU = 62893 kWh, dhe në vërejtje është evidentuar si vijon: *“Me urdhëresë nga KEDS kemi dal për kontrollë te konsumatori i lartpërmendur, ku hyrjet dhe daljet në njehsor janë në rregull, mirëpo bëhet ndërrimi i njehsorit dhe të faturohen kWh sipas procesverbalit, ku gjendja reale në njehsor është e cekur më lartë”*. Po te njëjtën dite ekipi i KEDS-it ka larguar nga matja njehsorin elektrik me nr. 38752424, me gjendje të shpenzimeve me TL = 41975 kWh dhe TU = 62893 kWh, si dhe, për matje është vendosur njehsori i ri me nr. 40128912, me gjendje të shpenzimeve në TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh dhe në vërejtje është konstatuar se: *“Në bazë të procesverbalit me nr. 2151109 bëhet ndërrimi i njehsorit dhe merret në QK për verifikim”*.

Bordi më tej i ka analizuar edhe Listat e Leximit, Transaksionet dhe Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe ka gjetur se, në periudhat 03-04/2020, punëtorët e autorizuar të KEDS nuk kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit dhe kjo është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në Pronë të Konsumatorit – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”*. Rrjedhimisht, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, sepse është dashur që të iu lejojë qasje punëtorëve të OSSh-së. Më tej, Bordi po ashtu ka gjetur se, dy periudha të tjera, është evidentuar nga lexuesi si “Vjedhje”, gjegjësisht në muajin 10/2023 dhe në muajin 12/2023. Po ashtu, nga analizimi i listave të leximit, ka gjetur se, konsumatori që nga periudha 04/2022 e deri me 01/2024 nuk është faturuar me kWh e shpenzuar në tarifën e lartë – TL, gjegjësisht shpenzimi është evidentuar me 0 kWh dhe se është faturuar vetëm me shpenzimet e shkaktuara në tarifën e ulet ku shpenzimet e tarifës se ulet përputhën plotësisht me faturimin e konsumatorit deri në periudhën 12/2023, por që Bordi i ZRrE konstaton se kjo është në kundërshtim me nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”*.



Bordi i ka shqyrtuar faturat kontestuese nr. 0124299523DPR-90082402 dhe nr. 0124299233DPR-90082402 datë 01.02.2024 dhe se kWh e faturuar përputhën plotësisht me te dhënat e shpenzimeve te evidentuara ne procesverbalin e inspektimit me nr. 2151109, i dt. 06.01.2024 dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0213665 i dt. 06.01.2024, dhe thekson se, ky faturim paraqet grumbullim të kWh që nga periudha 04/2022 e deri me 01/2024, për periudhën kohore që konsumatori nuk është faturuar me kWh e shpenzuar në tarifën e lartë.

Bordi më tej e ka analizuar edhe Korrigjimin financiar nr.104207DPR-90082402 të dt. 12.06.2024 në vlerë prej **-839,41€** dhe thekson se, ky korrigjim si i tillë është i saktë, dhe bazohet në shpenzimet e faturuara të konsumatorit për periudhën 04/2022 e deri me 01/2024, andaj, konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër financiar. Më tej, në vërejtje të korrigjimit financiar është evidentuar si vijon: *“Lexim jo i rregullt në T1. Shpërndarje e kWh për periudhën 04/2022 deri 01/2024 duke u bazuar në procesverbalin e dt. 06.01.2024 dhe bazuar në leximet e raportuara në Case Code pasi që njehsori nuk është lexuar në T1, si 6 shifror, pas kalimit të 200.000 kWh”*. Po ashtu, Bordi thekson se, KESCO-ja ka vepruar në harmoni me nenin 28 par. 3 – Faturimi – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si vijon: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Kësisoj, pavarësisht lëshimit/gabimit të lexuesit, konsumatori është i obliguar që të paguajë faturën e energjisë elektrike të cilën e ka konsumuar.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **A.H** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.